



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më

Nr.

12.1.2026
100

Lënda: Për vetëmbledhjen e Komisionit Rregullator, për shqyrtimin e projektaktit “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1, datë 26.10.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”

Drejtuar: **Z. Ilirjan Celibashi**
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Komisionit Rregullator

I nderuar z. Komisioner,

Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator,


Me vendimin nr. 1, datë 26.10.2020, Komisioni Rregullator ka miratuar Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”. Në mbështetje të nenit 20, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij.

Neni 20, pika 1, shkronja "d" e Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e Rregullores së mbledhjeve të Rregullatorit.

Nisur nga sa më sipër dhe në përputhje me nenin 16 të Rregullores, po ju paraqesim këtë kërkesë për vetëmbledhjen e Komisionit Rregullator, për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin nr. 1, datë 26.10.2020, “Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”, si dhe projektvendimin së bashku me relacionin përkatës.

Arben Ristani **Anëtar i Komisionit Rregullator**

Bledar Skënderi **Anëtar i Komisionit Rregullator**





**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR**

Data
Nr. Prot

**RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR**

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1, DATË 26.10.2020, TË KOMISIONIT
RREGULLATOR, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT RREGULLATOR"**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË
FUQI**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij.

Neni 20, pika 1, shkronja "d" e Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e Rregullores së mbledhjeve të Rregullatorit.

Në përputhje me nenin 16 të Rregullores, Komisioni Rregullator paraqet kërkesën për vetëmbledhjen e tij, për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin nr. 1, datë 26.10.2020, "Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator".

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me vendimin nr. 1, datë 26.10.2020, Komisioni Rregullator ka miratuar Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator.

Projektvendimi që propozohet përcakton disa ndryshime të Rregullores. Ky projektvendim është i natyrës normative dhe për këtë arsye propozohen ndryshimet si më poshtë:

Titulli i vendimit propozohet të ndryshohet si vijon: "Për miratimin e Rregullores së mbledhjeve të Komisionit Rregullator" dhe për rrjedhojë pika 1 ndryshon si më poshtë:

"1. Miratimin e Rregullores së mbledhjeve të Komisionit Rregullator, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi."

Në tekstin e Rregullores propozohet të bëhen edhe këto ndryshime:

1. Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:
 - Shkronja "c" e pikës 1, ndryshohet si më poshtë:
"c) Ngarkon Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të marrë masa për njoftimin e mbledhjes dhe dërgimin e materialeve të mbledhjes tek anëtarët e Komisionit Rregullator, përfaqësuesit e partive politike parlamentare, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore dhe personat e tretë sipas rastit.



- Shkronja “a” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:
“a) t’i kërkojë informacion, dokumentacion dhe mbështetje, si dhe t’i lërë detyra sipas nevojave administratës së KQZ-së, e cila ka detyrimin t’u përgjigjet kërkesave dhe të vërë në dispozicion kopje të çdo dokumentacioni që administrohet nga KQZ, sipas kërkesës.
- Pas shkronjës “b” të pikës 2 shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:
“b/1. Të kërkojë praninë në mbledhjet e Rregullatorit të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhorë, organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara dhe me përvojë në fushën e zgjedhjeve si dhe çdo subjekt që ka interes të ligjshëm për projektaktin që shqyrtohet.”.
- 2. Në nenin 7 propozohen ndryshimet si më poshtë:
“ 7. Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave që burojnë nga Kodi Zgjedhor, kryetari dhe çdo anëtar i Komisionit Rregullator mbështetet dhe asistohet nga administrata e KQZ.”.
- 3. Neni 17, pika 3 ndryshohet si më poshtë:
“3. Në çdo rast, kryetari dhe çdo anëtar i Komisionit Rregullator mund të thërrasë për shpjegime zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së që kanë lidhje me projektaktin që shqyrtohet.”.
- 4. Neni 33 ndryshohet si vijon:

“Neni 33

Forma e aktit

1. Akti i miratuar nga Komisioni Rregullator është i shkruar dhe përmban:
 - a. Stemen e Republikës së Shqipërisë;
 - b. Emrin e institucionit (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve);
 - c. Logon e institucionit (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve);
 - d. Emrin e organit që nxjerr aktin (Komisioni Rregullator);
 - e. Titullin e aktit;
 - f. Preambulën e aktit ku përfshihen dispozitat e kompetencës së nxjerrjes së aktit, dispozitat autorizuese për nxjerrjen e aktit si dhe propozuesi i aktit;
 - g. Përmbajtjen e aktit;
 - h. Emrat e anëtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhje;
 - i. Mënyrën e votimit të secilit anëtar (pro/kundër);
 - j. Numrin, datën dhe orën e miratimit.
2. Akti nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje, pasi të kenë verifikuar përmbushjen e vullnetit të tyre të shprehur me votë.”.
- Pas nenit 33, shtohet neni 33/1 me këtë përmbajtje:

Në rast ankimi në Kolegjin Zgjedhor të aktit të Komisionit Rregullator, anëtari/anëtarët që kane votuar kundër, kanë të drejtë të arsyetojnë mendimin kundër. Mendimi kundër publikohet në faqen zyrtare të internetit të KQZ-se bashkë me vendimin.
- Pika 2 e nenit 34 shfuqizohet.

Sa më lart në këtë relacion, Komisioni Rregullator, brenda kompetencave të veta të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vetëmbledhet për shqyrtimin e projektvendimit "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1, datë 26.10.2020 të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator".

Arben Ristani

Anëtar i Komisionit Rregullator

Bledar Skënderi

Anëtar i Komisionit Rregullator





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1, DATË 26.10.2020, TË KOMISIONIT
RREGULLATOR, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT RREGULLATOR"

Në mbështetje të nenit 12, pika 4, nenit 20, pika 1, shkronja "d", të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e dy anëtarëve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

- I. Në vendimin nr.1, datë 26.10.2020, të Komisionit Rregullator, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:
 1. Titulli i vendimit ndryshon si më poshtë:
"Për miratimin e Rregullores së mbledhjeve të Komisionit Rregullator".
 2. Pika 1 ndryshon si më poshtë:
"1. Miratimin e Rregullores së mbledhjeve të Komisionit Rregullator, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi."
- II. Në tekstin e Rregullores, miratuar me vendimin nr.1, datë 26.10.2020, të Komisionit Rregullator, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:
 1. Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:
 - a. Shkronja "c" e pikës 1, ndryshohet si më poshtë:
"c) Ngarkon Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të marrë masa për njoftimin e mbledhjes dhe dërgimin e materialeve të mbledhjes tek anëtarët e Komisionit Rregullator, përfaqësuesit e partive politike parlamentare, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore dhe personat e tretë sipas rastit.
 - b. Shkronja "a" e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:
"a) t'i kërkojë informacion, dokumentacion dhe mbështetje, si dhe t'i lërë detyra sipas nevojave administratës së KQZ-së, e cila ka detyrimin t'u përgjigjet kërkesave dhe të vërë në dispozicion kopje të çdo dokumentacioni që administrohet nga KQZ, sipas kërkesës.

Data: Nr:

Ora:



"Për disa ndryshime në vendimin nr.1, datë 26.10.2020, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator"

c. Pas shkronjës “b” të pikës 2, shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1. Të kërkojë praninë në mbledhjet e Rregullatorit të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhorë, organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara dhe me përvojë në fushën e zgjedhjeve si dhe çdo subjekt që ka interes të ligjshëm për projektaktin që shqyrtohet.”.

2. Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave që burojnë nga Kodi Zgjedhor, kryetari dhe çdo anëtar i Komisionit Rregullator mbështetet dhe asistohet nga administrata e KQZ.”.

3. Në nenin 17, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në çdo rast, kryetari dhe çdo anëtar i Komisionit Rregullator mund të thërrasë për shpjegime zyrtare të tjerë të administratës së KQZ-së që kanë lidhje me projektaktin që shqyrtohet.”.

4. Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33

Forma e aktit

1. Akti i miratuar nga Komisioni Rregullator është i shkruar dhe përmban:

- a. Stemën e Republikës së Shqipërisë;
- b. Emrin e institucionit (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve);
- c. Logon e institucionit (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve);
- d. Emrin e organit që nxjerr aktin (Komisioni Rregullator);
- e. Titullin e aktit;
- f. Preambulën e aktit ku përfshihen dispozitat e kompetencës së nxjerrjes së aktit, dispozitat autorizuese për nxjerrjen e aktit si dhe propozuesi i aktit;
- g. Përmbajtjen e aktit;
- h. Emrat e anëtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhje;
- i. Mënyrën e votimit të secilit anëtar (pro/kundër);
- j. Numrin, datën dhe orën e miratimit.

2. Akti nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje, pasi të kenë verifikuar përmbushjen e vullnetit të tyre të shprehur me votë.”.

5. Pas nenit 33, shtohet neni 33/1 me këtë përmbajtje:

Neni 33/1

Në rast ankimi në Kolegjin Zgjedhor të aktit të Komisionit Rregullator, anëtari/anëtarët që kanë votuar kundër, kanë të drejtë të arsyetojnë mendimin kundër. Mendimi kundër publikohet në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së bashkë me vendimin.

6. Pika 2 e nenit 34 shfuqizohet.

Data: Nr:

Ora:



“Për disa ndryshime në vendimin nr.1, datë 26.10.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ilirjana NANO	Kryetar
Arben RISTANI	Anëtar
Bledar SKËNDERI	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar

Data: Nr:

Ora:



"Për disa ndryshime në vendimin nr.1, datë 26.10.2020, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator"